



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2180 prot

Roskovec.më 26.03.2024

VENDIM

NR 18 . DATË 25.03.2024

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 92 DATË
23.10.2019 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES URBANE PËR BLOKUN
NR.2,QENDËR ROSKOVEC”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; të Ligjit Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar; të VKM Nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar; të Vendimit Nr.447 datë 16.06.2021 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, të VKB-së Nr.39 datë 31.05.2021,me Nr.4037 prot. datë 02.06.2021 “Për disa ndryshime mbi projektin “Rehabilitimi i bllokut Nr.1” pika Nr.2; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e disa shtesave në rregulloren urbane për bllokun Nr.2,Qendër Roskovec, sipas dokumentit bashkëlidhur.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,Spektori i Zbatueshmërisë së Investimeve,IMT-ja,Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

DRAFT RREGULLORE

**“Për disa shtesa në Rregulloren e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak
Nr. 92 datë 23.10.2019 “Për miratimin e rregullores urbane për bllokun nr.2, Qendër,
Roskovec.**

Neni 1

"Rregullore urbane e Bllokut Nr. 2" zëvendësohet me "Rregulloren Urbane për Bllokun Nr. 1, 2, 3, Roskovec"

Në të gjithë rregulloren emërtimi " Blloku nr. 2" zëvendësohet me "Blloku Nr.1, 2, 3, Roskovec".

Neni 2

Në pikën 2.4 shtohet baza ligjore si vijon:

Baza ligjore

- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar,
- Vendimi nr. 447, datë 16.6.2010 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”
- Ligji 89/2022 “Për policinë bashkiake”,
- Ligji Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.
- Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.
- VKB Nr. 39 date 31.05.2021, me nr. 4037 prot, date 02.06.2021“Per disa ndryshime mbi projektin “Rehabilitimi i bllokut nr 1”, pika nr.2.

Neni 3

Tek tabela e përmbajtjes “Rregulla të Përgjithshme” pika 2.5 ishte Harta e Bllokut nr. 2 Qendër Roskovec.

Tek tabela e përmbajtjes “Rregulla të Përgjithshme” bëhen ndryshimet si më poshtë:
Pika 2.5 bëhet Harta e Bllokut nr. 1, 2, 3, Roskovec.




Orthophoto e blloqeve urbane

47°29'1.818
4511082.478

<https://geoportal.asig.gov.al>
Data e Printimit: 20.02.2024.

47°59'5.052
4511082.478



<https://geoportal.asig.gov.al/ofron> të dhëna gjehapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësitë për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

47°29'1.818
4511082.478

Sistemi Koordinativ: KRGLSH
Projektimi: KRGLSH

47°59'5.052
4511082.478

Neni 4

Tek rregullat e përgjithshme shtohet pika 2.6 "Përkufizime" si më poshtë vijon:

1. "Bashkia" Bashkia Roskovec
2. "Fasade" të gjithë muret e jashtëm të ndërtimit të dukshëm nga rruga, që nuk janë vendosur përgjatë një ane, apo pjesës së pasme të pronës do të njihet si fasade.
3. "Reklama" pajisje publicitare, me rëndësi marketimi.
4. "Tenda" material sintetike apo pëlhura tekstili të vendosura në pjesën e jashtme të njësisë, pa pikëmbështetje në truall, që shërbejnë për mbrojtjen nga kushtet atmosferike.
5. "Grilat" element i fiksuar brenda ose jashtë, një dritareje që mund të jenë të mbyllura për siguri apo privatësi dhe për të mos lejuar dritën.
6. "Kondicionerë" pajisje motorrike që bëjnë të mundur ngrohjen apo ftohjen e ambienteve të banesës, subjektit privat apo publik.
7. "Antenat" element sinjalmarrës prej metali në forma dhe përmasa të ndryshme.
8. "Riparim" janë punime që kanë për qëllim kthimin e një objekti në kushte të pranueshme duke bërë ripërtëritjen, zëvendësimin, apo rregullimin e pjesëve të dëmtuara ose të degraduara
9. "Deklaratë paraprake për kryerje punimesh" është deklarata e depozituar pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit për punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi, sipas përcaktimeve në VKM NR. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.
10. "Ndërtim" është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë.
11. "Ndërtim/punim pa leje" janë ato procese dhe/ose objekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar
12. "Zona" është një pjesë e territorit, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese a të planifikuara të tokës e ndërtimeve në të, sipas rregullores të përdorimit të tokës. Zona mund të përpulhet ose jo me një apo më shumë njësi strukturore të territorit.

Neni 5

Në pikën 4.2 shtohet pika 4.2/a me përmbajtje si vijon:

4.2.a Rrethimi

Hapësira e lënë para banesave, sipërfaqja nga banesa deri te rruga, e cila në projektet e rehabilitimit të blloqeve nr 1, 2, 3, është sipërfaqe parku do të lihet në përdorim të banorëve, por në përdorimin e hapësirës nuk përfshihet ndërtimi apo rrethimi i objektit duke qenë se rrethimet ekzistuese janë prishur.

Neni 6

Pas pikës 4.6 shtohet pika 4.7 me përmbajtje si vijon:

4.7 Depozitat dhe Panelet diellore

Rast pas rasti sipas kërkesave/ ankesave që paraqiten nga qytetarët, pas verifikimit nga specialistët përkatës që vërtetojnë se konstruksioni mbajtës i tarracës dhe i godinës në tërësi lejon ose nuk lejon vendosjen e depozitave/ paneleve diellore në tarracat e përbashkëta, heqja e depozitave të ujit të pijshëm që shkakton dëmtime në objekt, do të kryhet në mënyrë vullnetare nga pronarët e objekteve, ose në mungesë të tyre prej shfrytëzuesve aktual të ambienteve të banimit, të cilët kanë në përdorim këto depozita.

Persa i perket paneleve diellore per perdorim hidrosanitar do te percaktohet vendosja ose jo e tyre pas verifikimit ne objekt nga specialistet perkates.

Neni 7

Tek pika 6.2 Ligji 8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe komunës”, ndryshohet me Ligjin Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”.

Përgatitën:

Përgjegjës I Sektorit të Planifikimit dhe Lejeve të Ndërtimit

Eva Hatia



Drejtor I Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Eneida Hoxha



Përgjegjës I Sektorit të Zbatueshmërisë së Investimeve

Arben Dukaj

